



SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

Drejtor botimi: Elsa Dhuli

Punoi: INSTAT

© Copyright INSTAT 2021

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356
Fax: +355 4 2222 411
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

PËRMBAJTA

POPULLSIA.....	7
STATISTIKAT VITALE.....	9
STATISTIKAT E KONSUMIT TË NJEF.....	11
STATISTIKAT E KUSHTEVE TË BANIMIT.....	13
STATISTIKAT E VARFËRISË RELATIVE OSE PËRJASHTIMIT SOCIAL.....	15
STATISTIKAT E TË ARDHURAVE DHE PABARAZISË.....	17
SHPENZIMET PUBLIKE NË SHËNDETËSI.....	19
SHËRBIMI PARËSOR.....	21
SHKAQET E VDEKJEVE.....	23
AFTËSIA E KUFIZUAR.....	25
VETË-PERCEPTIMI I GJENDJES SË PËRGJITHSHME SHËNDETËSORE.....	27
PERSONA TË PËRFSHIRË NË SISTEMIN E DREJTËSISË.....	29
VEPRA PENALE KUNDËR PERSONIT.....	31
SHPENZIMET PUBLIKE NË ARSIM.....	33
STATISTIKA TË REGJISTRIMEVE NË ARSIM.....	35
STATISTIKA TË DIPLOMIMEVE NË ARSIM.....	37
ARTI DHE KULTURA.....	39
TRASHËGIMI KULTURORE.....	41
PUNËSIMI.....	43
PAPUNËSIA.....	45
ÇMIMET E KONSUMIT.....	47
PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO SIPAS METODËS SË PRODHIMIT.....	49
PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO SIPAS METODËS SË SHPENZIMEVE.....	51

TREGTIA E JASHTME.....	53
TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT NË NDËRMARRJE.....	55
STATISTIKAT E PËRDORIMIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT NË FAMILJE DHE INDIVIDË..	57
BUJQËSIA(Bimët e arave).....	59
BUJQËSIA(Drufrutorët).....	61
BLEGTORIA.....	63
PESHKIMI.....	6
SMJEDISI.....	67
CILËSIA E UJËRAVE LARËS NË PLAZHET E SHQIPËRISË.....	69
PYJET.....	71
BIODIVERSITETI.....	73
TRANSPORTI.....	75
TURIZMI NË SHQIPËRI(Lëvizja e shtetasve)...	77
TURIZMI NË SHQIPËRI (Strukturat akomoduse).....	79
TURIZMI NË SHQIPËRI(Statistikat e turizmit të familjeve).....	81
INOVACIONI 2018-2020.....	83
INOVACIONI.....	85

**SHQIPËRIA NË
SHIFRA
2020**





SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

POPULLSIA



FIG. 1 LINDJET, VDEKJET DHE MIGRACIONI NETO





FIG.2 POPULLSIA MË 1 JANAR SIPAS GRUPMOSHAVE



TAB. 1 POPULLSIA E SHQIPËRISË

	Njësia	2019	2020	2021
Popullsia më 1 janar	Milion	2,86	2,85	2,83
0-14	në përqindje	17,2	16,8	16,5
15-59	-	62,4	61,9	61,6
60-79	-	17,7	18,4	18,9
80 +	-	2,7	2,9	3,0

Popullsia e Shqipërisë më 1 janar 2021 rezulton 2,83 milion banorë, duke pësuar rënie prej 0,6 % krahasuar me një vit më parë.

Gjatë vitit 2020 kanë lindur rreth 28,1 mijë foshnje, ndërsa kanë vdekur rreth 27,6 mijë persona. Numri i lindjeve vazhdon të tejkalojë numrin e vdekjeve, pavarësisht se diferenca midis tyre po ngushtohet me kalimin e viteve. Kjo diferencë në vitin 2020 është rreth 500 banorë.

Migracioni neto vazhdon të mbetet negativ (diferenca midis imigrantëve dhe emigrantëve), duke rezultuar në rreth 16,7 mijë persona për vitin 2020 të larguar, më shumë se sa të ardhur.

Më 1 janar 2021 grupmosha 60-79 vjeç zë 18,9 % të popullsisë gjithsej, nga 18,4 % që zinte më 1 janar të vitit 2020. Tendencë në rritje shfaq edhe grupmosha mbi 80 vjeç.

Grupmosha 0-14 vjeç paraqet tendencë në rënie, duke zënë 16,5 % të popullsisë më 1 janar të vitit 2021, krahasuar me 16,8 % që zinte më 1 janar të vitit 2020.

A EDINI SE?

Ajla dhe Deon janë emrat më popullore për të sapolindurit gjatë vitit 2020. Amelia dhe Amar janë emrat e dytë më popullore për të sapolindurit gjatë vitit 2020.

SHOIPËRIA NË SHIFRA 2020



STATISTIKAT VITALE



TAB. 1 TREGUES KRYESOR PËR POPULLSINË E SHQIPËRISË

	Njësia	2018	2019	2020
Jetëgjatësia	vite	78,9	79,0	77,3
Meshkuj	-	77,4	77,6	75,2
Femra	-	80,5	80,6	79,6
Indeksi sintetik i fekonditetit	për grua	1,37	1,36	1,34
Mosha mesatare në martesë	vite			
Meshkuj	-	31,0	30,9	31,1
Femra	-	27,4	27,8	27,7
Martestat	për 1000 banorë	8,1	7,9	6,2
Lindjet	-	10,1	10,0	9,9
Vdekjet	-	7,6	7,7	9,7
Vdekshmëria foshnjore	për 1000 lindje	8,9	10,3	10,0
Vdekshmëria nën 5 - vjeç	-	10,1	11,0	10,9

Përkufizim:

INDEKSI SINTETIK I FEKONDITETIT: Numri mesatar i fëmijëve që një grua mund të lindë gjatë periudhës së saj riprodhuese 15-49 vjeç.

JETËGJATËSIA MESATARE NË LINDJE: Numri mesatar i viteve që një i lindur sot pritët të jetojë, duke marrë parasysh normat aktuale të vdekshmërisë.

Në vitin 2020 jetëgjatësia për meshkujt është 75,2 vjet dhe për femrat është 79,6 vjet. Ky tregues ka pësuar rënie për të dy gjinitë krahasuar me 2019, si pasojë e pandemisë së shkaktuar nga Covid 19. Rënia më e madhe vihet re tek meshkujt, ku jetëgjatësia ka pësuar rënie me rreth 2 vite.

Indeksi sintetik i fekonditetit vazhdon të jetë nën nivelin e zëvendësimit (2,1 fëmijë për grua).

Në vitin 2020 numri mesatar i fëmijëve për grua ishte 1,34 duke shënuar rënie krahasuar me vitin 2019, kur ky indeks ishte 1,36 fëmijë për grua.

Në vitin 2020 mosha mesatare në martesë për femra ka pësuar ulje të lehtë krahasuar me 2019, ndërsa ky tregues për meshkujt ka pësuar rritje. Një burrë martohet mesatarisht në moshën 31,1 vjeç dhe një grua mesatarisht në moshën 27,7 vjeç.

Vdekshmëria foshnjore në 2020 është rreth 10 vdekje për një mijë lindje të gjalla, duke pësuar një ulje krahasuar me 2019.






STATISTIKAT E KONSUMIT TË NJEF



FIG. 1 STRUKTURA E SHPENZIMEVE TË GRUPEVE KRYESORE TË KONSUMIT



Struktura e shpenzimeve mesatare mujore për konsum të NjEF sipas 12 grupeve kryesore të konsumit tregon se grupet “Ushqime, pije alkoolike dhe duhan” zënë peshën kryesore në buxhetin familjar me 45,0 %, duke ruajtur të njëjtën tendencë me vitin e kaluar. Këto grupe kanë shënuar një rënie të shpenzimeve mesatare për konsum mujor krahasuar me vitin 2018, me rreth 3,1 pikë përqindje. Ndërsa rritje prej rreth 0,6 pikë përqindje është regjistruar në grupin “Të tjera mallra dhe shërbime”, grup i cili i dedikohet më së shumti shpenzimeve për kujdes personal. Përqindja e buxhetit të NjEF për grupin “Arsim”, zë një peshë prej 3,1 % duke shënuar rritje prej 0,1 pikë përqindje krahasuar me vitin 2018. Grupet e shpenzimeve për banesën (energji elektrike, ujë, lëndë djegëse, qira e paguar) dhe mobilim zënë 16,8 % të totalit të buxhetit familjar duke shënuar rritje prej 0,2 pikë përqindje krahasuar me vitin e mëparshëm.

**Përkufizim:**

Një njësi ekonomike familjare (NjEF) i referohet një grupi personash ose një personi me lidhje gjaku ose jo të cilët banojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.

A EDINI SE?

Në vitin 2019, grupi “Transport” ka shënuar një ulje vjetore me 5,5 %, krahasuar me vitin 2018, ndërsa rritja më e madhe vjetore është regjistruar në grupin “Argëtim dhe kulturë”, me 54,3 %.



SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

STATISTIKAT E KUSHTEVE TË BANIMIT TË NJEF



TAB 1. NJEF SIPAS LLOJIT TË BANESËS (NJEF NË %)

Lloji i banesës	2017	2018	2019
Shtëpi për një familje	71,7	71,2	72,7
Banesë në një ndërtesë me deri 15 apartamente	14,8	16,9	15,2
Banesë në një ndërtesë me më shumë se 15 apartamente	13,1	11,6	12,0
Tjetër	0,4	0,3	0,1

TAB 2. NJEF SIPAS SIPËRFAQES SË PËRDORUR TË BANESËS (NJEF NË %)

Sipërfaqja e banesës	2017	2018	2019
Më pak se 50 m2	7,5	7,2	6,3
51-90 m2	50,6	52,2	51,7
91-130 m2	34,8	33,9	35,0
Më shumë se 130 m2	7,1	6,7	7,0

TAB 3. NJEF SIPAS STATUSIT TË PRONËSISË SË BANESËS (NJEF NË %)

Statusi i pronësisë	2017	2018	2019
Pronar ose duke u berë pronar (ka marrë hua, kredi ose në pritje të legalizimit)	93,0	92,5	93,1
Me qira (nga një person privat ose nga shteti)	5,4	6,0	5,2
Jeton falas /e ka në përdorim /tjetër	1,6	1,5	1,7

Burimi: "Anketa e Buxhetit të Familjes 2017, 2018, 2019"

Sipas Anketës së Buxhetit të Familjes 2019, 72,7 % e Njërive Ekonomike Familjare (NjEF) jetojnë në shtëpi private. NjEF të cilat jetojnë në banesa që janë pjesë të ndërtesave me deri 15 apartamente zënë 15,2 %, përqindje e cila regjistron një ulje prej 1,7 pikë përqindje krahasuar me vitin 2018 ndërsa banesa që janë pjesë të ndërtesave me 15 apo më shumë apartamente zënë 12,0 % të NjEF në Shqipëri (Tab. 1).

Në vitin 2019 banesat me sipërfaqe 51-90 metra katrorë zënë peshën më të madhe me 51,7 %. (Tab. 2). Banesat me sipërfaqe 91 deri në 130 metra katrorë zënë një peshë prej 35,0 % në vitin 2019, përqindje e cila regjistron një rritje prej 1,1 pikë përqindje krahasuar me vitin 2018.

Pjesa më e madhe e banesave janë në pronësi të familjeve, 93,1 %. Kategoritë e tjera, banesa të marra me qira, 5,2 %, dhe NjEF që jetojnë falas ose në përdorim zënë një përqindje shumë të vogël të banesave, 1,7 % (Tab. 3).

Përkufizim:



Sipërfaqja: Sipërfaqja e banimit nga NjEF (nuk përfshihen verandat, ballkonet, garazhet apo sipërfaqet e përbashkëta në përdorim). Lloji i banesës: klasifikimi i banesave sipas llojit dhe përbërjes së tyre.



AEDINISE?

Në familjet që banojnë në banesa për qëllime banimi, 4,6 % e tyre jetojnë në kushte mbipopullimi të cilat kanë një sipërfaqe mesatare rreth 12,6 metra katrorë për person.

SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020



STATISTIKAT E VARFËRISË RELATIVE OSE PËRJASHTIMIT SOCIAL




TAB 1. TREGUESIT KRYESORË TË RREZIKUT PËR TË QENË I VARFËR OSE PËRJASHTIMIT SOCIAL, 2017, 2018, 2019

Treguesit	2017	2018	2019
Kufiri i rrezikut për të qenë i varfër; familje me një person (Lekë)	145.017	160.742	170.785
Rreziku për të qenë i varfër (%)	23,7	23,4	23,0
Individët thellësisht të privuar materialisht (%) (mungesa e 4 nga 9 kategoritë e privimit material)	41,1	38,3	37,1
Intensitetet shumë të ulët në punësim (individë 18-59 vjeç) (%)	14,4	13,3	12,4
Rreziku për të qenë i varfër ose përjashtimi social (AROPE) (%)	51,8	49,0	46,2

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2017, 2018, 2019

FIG 1. RREZIKU PËR TË QENË I VARFËR SIPAS TIPIT TË FAMILJES 2017 2018 2019 (% E INDIVIDËVE)



Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2017, 2018, 2019

Përkufizim:

Treguesi i rrezikut për të qenë i varfër tregon përqindjen e personave që jetojnë në familje ku të ardhurat e disponueshme të ekuivalentuara janë nën kufirin e rrezikut për të qenë i varfër (i përcaktuar në 60 % të medianës së të ardhurave të ekuivalentuara).

Rreziku për të qenë i varfër ose përjashtimi social (AROPE)

i referohet individëve që janë në rrezik për të qenë të varfër ose thellësisht të privuar materialisht ose që jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët në punësim.

Nga Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ), **kufiri i rrezikut për të qenë i varfër** për një person në vitin 2019 është vlerësuar me 170.785 lekë, në krahasim me 160.742 Lekë që ishte në vitin 2018 dhe 145.017 lekë që ishte në vitin 2017.

Treguesi i rrezikut për të qenë i varfër në Shqipëri, në vitin 2019 është 23,0 %, duke pësuar një rënie prej 0,4 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2018 dhe 0.7 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2017.

Shkalla e thelluar e privimit material është vlerësuar 37,1 % në vitin 2019, kundrejt 38,3 % vlerësuar në vitin 2018.

Individët e grupmoshës 18-59 vjeç, të cilët jetojnë në familje me **intensitet shumë të ulët në punësim** në vitin 2019 sipas vlerësimeve përbëjnë 12,4 %, kundrejt 13,3 % rezultuar në vitin 2018, duke pasqyruar një rënie prej 0,9 pikë përqindje.

Në vitin 2019 rreziku për të qenë i varfër ose përjashtimi social është vlerësuar 46,2 %, kundrejt 49,0 % vlerësuar në vitin 2018.

Përqindja e individëve në rrezik për të qenë të varfër sipas tipit të familjes, në vitin 2019, në familjet pa fëmijë në varësi, vlerësohet të jetë më e ulët krahasuar me familjet me fëmijë në varësi, përkatësisht 14,2 % dhe 27,2 % e individëve.

A EDINI SE?



SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

STATISTIKAT E TË ARDHURAVE DHE PABARAZISË



TAB 1. TË ARDHURAT MESATARE MUJORE TË DISPONUESHME TË INDIVIDËVE, 2017, 2018, 2019 (NË LEKË)

	2017	2018	2019
Të ardhurat mesatare mujore për frymë/ të ekuivalentuara (Lekë)	24.526	26.144	27.849

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2017, 2018, 2019

TAB 2. TREGUESIT E PABARAZISË 2017, 2018, 2019

	2017	2018	2019
Koeficienti GINI	36,8	35,4	34,3
Raporti S80/S20	7,5	7,0	6,4

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2017, 2018, 2019

Nga anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (SILC) në vitin 2019, të ardhurat mesatare mujore të disponueshme për frymë/të ekuivalentuara janë rritur me 6,5 % krahasuar me vitin 2018 (Tab. 1).

Në vitin 2019, **Koeficienti Gini** është vlerësuar 34,3 %, duke pësuar rënie me 1,1 pikë përqindje nga viti 2018.

Raporti i kuintileve të të ardhurave disponibël të ekuivalentuara, S80/S20 në vitin 2019 është vlerësuar me 6,4 nga 7,0 që ishte në vitin 2018, duke paraqitur një ulje të pabarazisë.

Përkufizim:

Të ardhurat disponibël të ekuivalentuara janë konsideruar të ardhurat gjithsej disponibël të familjes pasi janë ndarë duke përdorur shkallën e ekuivalentuar të modifikuar të OECD.

Niveli i pabarazisë sipas shpërndarjes së të ardhurave matet nëpërmjet koeficientit Gini dhe raportit të kuintileve (kuintili i fundit me kuintilin e parë) të të ardhurave disponibël të ekuivalentuara (S80/S20).



Në vitin 2019 Raporti S80/20 për popullsinë 65 vjeç e lart tregon një pabarazi shumë më të vogël (4,1) krahasuar me popullsinë nën 65 vjeç (6,8).




SHOIPËRIA NË SHIFRA 2020

SHPENZIMET PUBLIKE NË SHËNDETËSI



FIG.1 SHPENZIMET PUBLIKE NË SHËNDETËSI



Burimi i informacionit: Ministria e Financave dhe Ekonomisë(MFE), INSTAT

TAB. 1 SHPENZIMET PUBLIKE PËR SHËNDETËSINË (MLN LEKË)

VITI	Shpenzimet publike per shëndetësinë (mln Lekë)
2008	26.713
2009	30.738
2010	32.658
2011	35.024
2012	36.535
2013	35.391
2014	41.881
2015	38.578
2016	41.802
2017	45.352
2018	49.004
2019	51.182
2020	51.590

Burimi i informacionit: Ministria e Financave dhe Ekonomisë(MFE)

Shpenzimet publike në sektorin e shëndetësisë për vitin 2020 janë 51.590 miliardë lekë.

Këto shpenzime përbëjnë 9,68 % të shpenzimeve publike gjithsej për vitin 2020 dhe zënë një peshë prej 3,21 % në PBB-në gjithsej. Krahësuar me vitin 2019, shpenzimet publike në shëndetësi shprehur si përqindje ndaj PBB kanë shënuar rritje me 0,2 pikë përqindje, ndërkohë shpenzimet publike në shëndetësi shprehur si përqindje ndaj shpenzimeve publike gjithsej, kanë shënuar rënie me 0,8 pikë përqindje.

Përkufizim:

Shpenzime Publike në shëndetësi –

Janë shpenzimet e kryera nga Buxheti i Shtetit për Shëndetësinë publike në qendra shëndetësore të specializuara ose njësi të ngjashme.



A EDINI SE?

Shpenzimet publike në shëndetësi përbëjnë 9,68 % të shpenzimeve publike gjithsej për vitin 2020 dhe përbëjnë 3,21 % në PBB-në gjithsej.



SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

SHËRBIMI PARËSOR



TAB. 1 NUMRI I VIZITAVE, PERSONELI MJEK /INFERMIERË NË SHËRBIMIN PARËSOR

Emërtimi	2018	2019	2020
Numri i vizitave	6.668.567	6.733.220	6.141.194
Mjek	1.814	1.787	1.801
Infermier	6.784	6.958	6.863

Burimi i informacionit: Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm i Kujdesit Shëndetësor.

*Janë përfshirë vizitat në qendrat që kanë kontratë me FSDKSH.

TAB.2 MBULIMI VAKSINAL

Mbulimi vaksinal	2018	2019	2020
-Tuberkulozin	99,1	98,9	97,9
- Difterine	99,8	98,9	98,5
-Tetanosin	99,8	98,9	98,5
- Kollen e mire	99,8	98,9	98,5
- Hepatitin B	99,8	98,9	98,5
- Haemophilus influenzae	99,8	98,9	98,5
- PoliomiELITIN	98,7	98,9	98,3
- Penumokokun	98,5	95,6	92,4
- Fruthin	94,1	95,0	91,0
- Rubeolen	94,1	95,0	91,0
- Parotitin	94,1	95,0	91,0

Burimi i informacionit: Instituti i Shëndetit Publik

Në vitin 2020, numri i vizitave në shërbimin parësor si pika e parë e kontaktit me shërbimin shëndetësor nga popullata, ka pësuar një rënie me 8,8 %, krahasuar me një vit më parë. Numri i infermierëve në këtë shërbim ka një rënie me 1,4 %, ndërkohë numri i mjekëve në këtë shërbim krahasuar me një vit më parë ka një rritje me 0,8 %.

Në vitin 2020, vaksinimi brenda vitit të parë të jetës sipas skemës kombëtare të vaksinimit vazhdon të jetë i lartë për të gjitha llojet e vaksinave. Edhe pse vitet e fundit vërehet një ulje e mbulesës vaksinale ndaj Fruthit, Rubeolës dhe Parotitit, në vitin 2020, antigeni vaksinal është në nivelet mbi 91 % në nivel kombëtar, në përputhje kjo dhe me rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.



Përkufizim:

Shërbimi parësor është kontakti i parë që i ofrohet popullatës për shërbimet e shëndetit publik dhe promocionit.



A EDINI SE?

Në vitin 2020, numri i mjekëve në shërbimin parësor është rritur me 0,8 %, krahasuar me një vit më parë.



SHOIPËRIA NË SHIFRA 2020


SHKAQET E VDEKJEVE |

TAB. 1 VDEKJET SIPAS SHKAKUT (%)

Shkaqet e vdekjeve	2016	2017	2018	2019	2020
Natyrale	87.4	90.1	93.8	94.1	97.3
Aksident	2.3	2.4	2.4	2.7	1.7
Vetëvrasje	1.1	0.9	1	1	0.8
Vrasje	0.4	0.3	0.3	0.4	0.2
Panjohur	8.8	6.3	2.4	1.9	0

Burim i informacionit : INSTAT

FIG.1 VDEKSHMËRIA FOSHNJORE SIPAS SHKAKUT KRYESOR (%), 2020



Burim i informacionit : INSTAT

Numri i vdekjeve në vitin 2020 është 27.605, duke pësuar një rritje prej 25,8 %, krahasuar me një vit më parë. Vdekjet nga shkaqet natyrore përbëjnë 97,3 % të vdekjeve gjithsej, ndjekur nga Aksidentet (1,7 %) si shkak i dytë kryesor i vdekjeve të raportuara në vend. Krahasuar me vitin e kaluar, vetëm vdekjet nga shkaqet natyrore kanë pësuar rritje (30,2 %), ndërkohë vdekjet nga aksidentet, vrasjet dhe vetëvrasjet kanë pësuar rënie.

Në vitin 2020, numri i vdekjeve foshnjore është 281, duke shënuar një rënie prej 4,1 %, krahasuar me vitin 2019. Shkaqet kryesore të vdekshmërisë foshnjore (nën 1 vjeç) janë “Ndërlikime në barrë, të lindjes dhe të periudhës së paslindjes” me 37,7 % dhe “Sëmundjet që shfaqen në periudhën rreth lindjes” me 29,9 % të vdekjeve gjithsej të kësaj grupmoshe.

**Përkufizim:**

Shkaku i vdekjes është sëmundja ose simptoma që ka shkaktuar ose kontribuar në vdekje, si dhe rrethanat e aksidentit që kanë shkaktuar këto trauma (Përshkruhet në certifikatën e vdekjes).

**A EDINI SE?**

Vdekjet nga shkaqet natyrore përbëjnë 97,3 % të vdekjeve gjithsej, ndjekur nga Aksidentet (1,7 %) si shkak i dytë kryesor i vdekjeve të raportuara në vend.




SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

AFTËSIA E KUFIZUAR




FIG. 1 FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUAR SIPAS GRUPMOSHAVE



Burim i informacionit: Shërbimi Social Shtetëror

FIG. 2 FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUAR QË NDJEKIN SHKOLLËN, SIPAS NIVELEVE



Burim i informacionit: Shërbimi Social Shtetëror

TAB. 1 PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË QENDRA TË SHËRBIMET PËRKUJDESIT

Emërtimi	2017	2018	2019	2020
Numri i individëve me aftësi të kufizuar në qendrat për shërbimet epërkujdesit	1.794	1.786	2.152	2.205
Publik	814	833	1.145	1.098
Jo-Publik	980	953	1.007	1.107

Burim i informacionit: Shërbimi Social Shtetëror

Përkufizim:



Aftësia e kufizuar është një fenomen kompleks ndërveprimi mes individëve me një gjendje shëndetësore dhe faktorëve personal dhe mjedisor (p. sh. qëndrimet negative, transporti i paarritshëm dhe ndërtesat publike dhe mbështetja e kufizuar sociale).

Personat me aftësi të kufizuar janë pjesë e skemave të Mbrojtjes Sociale. Në vitin 2020, 21,3 % të personave të kësaj kategorie i përkasin grupmoshës 0-18 vjeç. Shumica e fëmijëve me aftësi të kufizuar i përkasin grupmoshës 6-14 vjeç (48,6 %).

Në vitin 2020, nga totali i fëmijëve me aftësi të kufizuar, 53,1 % ndjekin shkollën sipas nivele përkatëse arsimore. Shumica e fëmijëve janë me arsim 9 vjeçar, pasi dhe numri i madh i tyre i përket moshës 6-14 vjeç.

Për një kategori të caktuar të personave me aftësi të kufizuar ofrohen shërbime të përkujdesit specifik, në qendra publike dhe jo-publike. Në vitin 2020, numri i personave që marrin shërbimet e përkujdesit në këto qendra është 2.205, duke shënuar një rritje me 2,5 % krahasuar me vitin 2019.

A EDINI SE?

Rreth 50 % e fëmijëve me aftësi të kufizuar i përkasin grupmoshës 6-14 vjeç.



SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

VETË-PERCEPTIMI I GJENDJES SË PËRGJITHSHME SHËNDETËSORE



TAB. 1 VETË PERCEPTIMI I GJENDJES SË PËRGJITHSHME SHËNDETËSORE PËR INDIVIDËT 16 VJEÇ E LART

Vetë perceptimi i gjëndjes së përgjithshme shëndetës për individët 16 vjeç e lart (%)			
	2017	2018	2019
Shumë mire ose mirë	81,4	81,8	82
Disi	13,3	13,1	13,3
Keq ose shumë keq	5,3	5,1	4,8

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2017, 2018, 2019

TAB. 2 PËRQINDJA E INDIVIDËVE 16 VJEÇ E LART QË KANË PATUR NEVOJA TË PAPLOTËSUARA PËR KUJDES MJEKËSOR DHE DENTAR

	% e individëve 16+		
	2017	2018	2019
Nevojë e paplotësuar për ekzaminim ose trajtim mjekësor	19,0	21,5	21,2
Nevojë e paplotësuar për ekzaminim ose trajtim dentar	20,5	23,6	23,4


Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2017, 2018, 2019

Në vitin 2019, 82,0 % e individëve 16 vjeç e lart kanë deklaruar se gjendja e tyre shëndetësore ka qenë shumë mirë ose mirë kundrejt 81,8% që ishte në vitin 2018.

Bazuar në vetë-perceptimin e individëve 16 vjeç e lart 4,8 % e individëve kanë deklaruar se gjendja e tyre shëndetësore ka qenë keq ose shumë keq, duke pësuar rënie me 0,3 pikë përqindje krahasuar me vitin 2018.

Në vitin 2019, 23,4 % e individëve 16 vjeç e lart kanë raportuar se kanë nevojë të paplotësuar për ekzaminim ose trajtim dentar, krahasuar me 23,6 % që ishte në vitin 2018.

Nevojat e paplotësuar për ekzaminim ose trajtim mjekësor ose dentar lidhen me një sërë arsyesh ku mund të përmenden mos përballimi financiar i shërbimit (shumë i shtrenjtë), pritja në listë, mungesa e kohës për shkak të punës, largësia ose mungesa e transportit, në pritje se mos kalon vetë problemi i tyre shëndetësor, etj.





SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020


PERSONA TË PËRFSHIRË NË SISTEMIN E DREJTËSISË



TAB.1 PERSONA TË PËRFSHIRË NË SISTEMIN E DREJTËSISË PENALE

	2018		2019		2020	
	Nr	Për 10 mijë banorë	Nr	Për 10 mijë banorë	Nr	Për 10 mijë banorë
Të dyshuar	39.649	155,9	43.045	167,4	40.956	159,9
Të arrestuar	10.569	41,5	11.441	44,5	11.940	46,6
Të dëmtuar	19.101	66,6	18.858	66,1	17.829	62,8
Të pandehur	16.249	67,6	14.723	61,2	13.409	55,9
Të dënuar me burg	3.096	12,9	2.781	11,6	2.289	9,5
Të paraburgosur	2.220	9,2	2.264	9,4	2.325	9,7

FIG.1 PERSONA TË PËRFSHIRË NË SISTEMIN E DREJTËSISË PENALE PËR 10 MIJË BANORË



Në vitin 2020, janë regjistruar nga policia 40.956 persona të dyshuar, 4,9 % më pak, krahasuar me vitin e kaluar. Në raport me popullsinë janë 159,9 të dyshuar për 10 mijë banorë. Persona të arrestuar në vitin 2020 janë 11.940 ose 46,6 persona për 10 mijë banorë. Në vitin 2020 janë regjistruar 17.829 persona të cilëve i'u është shkelur ose rrezikuar çfarëdo e drejtë personale ose pasurore nga veprat penale. Në raport me popullsinë janë 62,8 të dëmtuar për 10 mijë banorë. Persona të pandehur për vepra penale, në vitin 2020 janë regjistruar 13.409 ose 55,9 të pandehur për 10 mijë banorë. Gjendja e të burgosurve në IEVP në 31 dhjetor 2020 është 2.289 të dënuar me burg dhe 2.325 të paraburgosur, ndaj të cilëve është marrë masë sigurimi "arrest në burg". Në raport me popullsinë janë 9,5 të dënuar me burg dhe 9,7 persona të paraburgosur.

Përkufizim:**I pandehur:**

Konsiderohet personi të cilit i është atribuar vepra penale përmes aktit të njoftimit të akuzës, i cili përmban dëshmi të mjaftueshme për marrjen e personit si i pandehur.

A EDINI SE?

Gjatë vitit 2020, janë regjistruar mesatarisht 37 persona të pandehur në ditë.



SHOIPËRIA NË SHIFRA 2020

VEPRA PENALE KUNDËR PERSONIT



TAB.1 VEPRA PENALE KUNDËR PERSONIT, 2020

Vepra penale kundër personit	Vepra penale	Autorë
Krime kundër jetës	1411	1605
Vrasje	52	70
Vrasje mbetur tentativë	114	139
Vrasje nga pakujdesia	7	7
Kanosje	1233	1386
Të tjera	5	3
Krime kundër shëndetit	2538	3362
Plagosje e rëndë me dashje	146	214
Plagosje e lehtë me dashje	1069	1490
Dëmtime tjera me dashje	1305	1637
Të tjera	18	21
Krime seksuale	146	165
Vepra penale kundër lirisë së personit	182	215
Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë	34	38
Heqja e paligjshme e lirisë	19	36
Dhunim banese	98	97
Të tjera	31	44
Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit	410	478
Prostitucioni	19	47
Shfrytëzim prostitucioni	60	83
Mbajtja e lokaleve për prostitucion	20	42
Fyerja	70	82
Përndjekja	156	149
Të tjera	85	75
Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes	1648	1750
Braktisja fëmijës së mitur	46	46
Trafikimi i të miturit	5	5
Dhuna në familje (130/a)	1505	1604
Të tjera	92	95
Të tjera kundër personit	40	30
Gjithsej	6375	7605

Burimi: Drejtoria e Policisë së Shtetit

Vepra penale kundër personit përfshijnë ato vepra të cilat prekin ose vënë në rrezik jetën, shëndetin, liritë, paprekshmërinë seksuale, nderin e dinjitetin e personit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal. Në vitin 2020 janë evidentuar 6.375 vepra penale kundër personit, 3,6 % më shumë krahasuar me vitin 2019. Këto vepra penale përbëjnë 19,5 % të totalit të gjithë veprave penale të evidentuara për vitin 2020. Ndërkohë janë regjistruar 7.605 autorë të dyshuar për vepra penale kundër personit, 3,6 % më shumë krahasuar me vitin 2019.

Krime kundër shëndetit përbën numrin më të madh të veprave penale dhe autorëve të regjistruar, ndjekur më pas nga veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes dhe krimet kundër jetës.

Përkufizim:



Vepra penale: Sjelle, veprime apo mosveprime me të cilat cënohen, dëmtohen vlerat juridike të njeriut dhe të bashkësisë së caktuar quhen vepra penale apo me një term të përgjithshëm kriminalitet. Ato ndahen në krime dhe kundërvajtje penale.



Gjatë vitit 2020, u evidentuan mesatarisht rreth 3 kanosje në ditë.

Në vitin 2020, vepra Dhuna në familje përbën 91,3 % të veprave të evidentuara kundër fëmijëve, martesës dhe familjes.




SHOIPËRIA NË SHIFRA 2020

SHPENZIMET PUBLIKE NË ARSIM



FIG. 1 SHPENZIMET PUBLIKE NË ARSIM



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE)/INSTAT

* Të dhënat për PBB-në janë gjysëm-finale

** Të dhënat për PBB-në janë bazuar në vlerësimet tremujore

TAB. 1 SHPENZIMET PUBLIKE NË ARSIM

Viti	Shpenzimet publike për Arsimin (mln Lekë)
2013	44.131
2014	46.208
2015	44.691
2016	46.079
2017	47.914
2018	51.605
2019*	55.684
2020**	54.150

Burimi i informacionit: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, INSTAT

Shpenzimet publike në sektorin e arsimit për vitin 2020 kanë qenë 54.1 miliardë lekë. Këto shpenzime përbëjnë 10,2 % të shpenzimeve publike gjithsej për vitin 2020 dhe zënë një peshë prej 3,4 % në PBB-në gjithsej. Krahasuar me vitin 2019, shpenzimet publike në arsim shprehur si përqindje ndaj PBB kanë shënuar rritje me 0,1 pikë përqindje, ndërkohë shpenzimet publike në arsim shprehur si përqindje ndaj shpenzimeve publike gjithsej, kanë shënuar rënie me 1,2 pikë përqindje.

A EDINISE?

Shpenzimet publike në arsim përbëjnë 10,2 % të shpenzimeve publike gjithsej për vitin 2020 dhe zënë një peshë prej 3,4 % në PBB-në gjithsej.



SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

STATISTIKA TË REGJISTRIMEVE NË ARSIM




TAB.1 NXËNËS DHE STUDENTË TË REGJISTRUAR SIPAS NIVELE ARSIMORE

Niveli ISCED	Viti shkollor / akademik	2018-19	2019-20	2020-21
Të regjistruar gjithsej në arsim		641.161	612.534	589.604
0	Në Kopshte	78.942	77.858	71.332
1+2	Në arsimin 9 vjeçar:	306.530	294.879	286.486
1	Fillore	167.104	162.170	158.528
2	Cikli i lartë i arsimit 9 vjeçar	139.426	132.709	127.958
3	Në arsimin e mesëm:	116.646	109.533	107.989
34	Gjimnaz dhe Social -Kulturor	95.359	89.869	88.965
35	Profesional	21.287	19.664	19.024
5 deri 8	Në arsimin e lartë	139.043	130.264	123.797

Burimi i informacionit: Të dhënat administrative nga MASR dhe MFE*

FIG.1: PJESËMARRJA NË ARSIM SIPAS RAPORTEVE GER DHE NER (%)



Burimi i informacionit: Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, INSTAT*

TAB.2: RAPORTI NXËNËS PËR MËSUES, PTR

Niveli ISCED	Viti shkollor / akademik	2018-19	2019-20	2020-21
Të regjistruar gjithsej në arsim		641.161	612.534	589.604
0	Në Kopshte	78.942	77.858	71.332
1+2	Në arsimin 9 vjeçar:	306.530	294.879	286.486
1	Fillore	167.104	162.170	158.528
2	Cikli i lartë i arsimit 9 vjeçar	139.426	132.709	127.958
3	Në arsimin e mesëm:	116.646	109.533	107.989
34	Gjimnaz dhe Social -Kulturor	95.359	89.869	88.965
35	Profesional	21.287	19.664	19.024
5 deri 8	Në arsimin e lartë	139.043	130.264	123.797

Burimi i informacionit: Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, INSTAT

Në vitin shkollor 2020-21, u regjistruan në të gjithë nivelet e arsimit zyrtar, 589.604 nxënës dhe studentë, me një ulje prej 3,7 %, krahasuar me të regjistruarit e vitit të kaluar. Në fillim të vitit shkollor 2020-21, pjesëmarrja bruto në të gjithë nivelet e arsimit, në krahasim me popullsinë e moshës shkollore ose GER, ishte 82,8 %. Raporti i regjistrimit bruto është i ndryshëm në nivele të ndryshme arsimore. Për vitin shkollor 2020-21, GER në arsimin 9 vjeçar është 97,1 %, me një ulje prej 1,0 pikë përqindje nga viti paraardhës. GER në arsimin e mesëm është 93,5 %, ndërsa në arsimin e lartë është 59,2 %. NER llogaritet vetëm për arsimin parauniversitar. Në vitin 2020 morën pjesë në arsimin 9 vjeçar 93,0 % nxënës të grupmoshës 6-14 vjeç në krahasim popullsinë përkatëse, përkundrejt 93,9 % të tyre në vitin 2019.

Raporti nxënës për një mësues në arsimin fillor publik është 16,6 dhe në atë privat është 13,9. Ndërsa në ciklin e lartë të arsimit 9 vjeçar, ky raport është 8,9 në arsimin publik dhe 7,2 në atë privat. Në arsimin e mesëm raporti nxënës për një mësues është 13,4 në arsimin publik dhe 8,9 në atë privat.

A EDINI SE?

Në fillim të vitit shkollor 2020-21, pjesëmarrja bruto në të gjithë nivelet e arsimit, në krahasim me popullsinë e moshës shkollore ose GER, ishte 82,8 %.




SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

STATISTIKA TË DIPLOMIMEVE NË ARSIM




FIG.1: SHKALLA E DIPLOMIMIT NË ARSIMIN E MESËM, GGR (%)



Në vitin shkollor 2019-20, u diplomuan në arsimin zyrtar 98.169 nxënës dhe studentë, me një ulje prej 5,5 %, krahasuar me vitin shkollor 2018-19. Në arsimin 9 vjeçar u diplomuan 33.618 nxënës. Këtë vit përfunduan studimet në arsimin e mesëm dhe u diplomuan 31.662 nxënës, me një raport bruto të diplomimit GGR prej 81,5 %.

TË DIPLOMUAR NË ARSIMIN E LARTË SIPAS FUSHAVE TË STUDIMIT, 2020



Në vitin 2020, janë diplomuar në arsimin e lartë 32.889 studentë. Në të gjithë programet e arsimit të lartë, në këtë vit akademik, u diplomuan 21.481 studente femra, ose 65,3 % e numrit të përgjithshëm të studentëve të diplomuar në arsimin e lartë. Fusha në të cilën janë diplomuar më shumë studentë në të gjitha programet është “Biznes, administrim dhe ligj” prej 28,7 % ose mbi një e katërta e numrit të përgjithshëm të të diplomuarve. Fusha e dytë më e preferuar nga meshkujt është “Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim” me 20,0 % e të diplomuarve. Ndërsa, nga femrat gjithsej të diplomuara, fusha e dytë e preferuar është “Shëndet dhe mirëqenie” me 16,3 % të të diplomuarve.

A EDINISE?

Fusha në të cilën janë diplomuar më shumë studentë në të gjitha programet është “Biznes, administrim dhe ligj” prej 28,7 % ose mbi një e katërta e numrit të përgjithshëm të të diplomuarve.



SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

ARTI DHE KULTURA



TAB. 1 NUMRI I SHFAQJEVE DHE SPEKTATORËVE NË INSTITUCIONET QËNDRORE TË ARTIT

	Numri i shfaqjeve			Numri i spektatorëve			Pjesëmarrja mesatare		
	2018	2019	2020	2018	2019	2020	2018	2019	2020
Teatri Kombëtar Popullor	156	157	63	39.503	34.790	5.252	253	222	83
Teatri Kombëtar Eksperimental	457	444	135	65.989	64.684	16.044	144	146	119
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor	97	161	45	54.438	70.647	7.476	561	439	166
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	198	236	65	22.051	31.795	6.274	111	135	97
Cirku Kombëtar	124	126	20	34.968	21.698	3.286	282	172	164
Gjithsej	1.032	1.124	328	216.949	223.614	38.332	210	199	117

Burimi: Ministria e Kulturës

Në vitin 2020, në institucionet qendrore të artit janë organizuar 328 shfaqje dhe premiera kulturore. Krahasuar me vitet e kaluara, ky numër është shumë i ulët për shkak të situatës së krijuar nga pandemia. Megjithatë, institucionet e artit kanë vijuar veprimtarinë me shfaqje dhe premiera online, të publikuara në rrjete sociale. Në institucionet qendrore të artit, gjatë vitit 2020, morën pjesë në aktivitetet kulturore 38.332 spektatorë.

Përkufizim:



Pjesëmarrja mesatare e spektatorëve për shfaqje llogaritet me numrin total të spektatorëve në institucionet kulturore me numrin e shfaqjeve të realizuara në këto institucione.



A EDINISE?

Në vitin 2020, numri mesatar i spektatorëve për shfaqje është 117.

SHOIPËRIA NË SHIFRA 2020



TRASHËGIMIA KULTURORE



FIG.1: VIZITORË NË MUZE, PARQE ARKEOLOGJIKE DHE KALA





FIG.2: FREKUENTIMI I VIZITORËVE NË MUZE, PARQE ARKEOLOGJIKE DHE KALA



Të dhënat e trashëgimisë kulturore përfshijnë numrin e vizitorëve vendas dhe të huaj në Muzetë, Kalatë dhe Parqet Arkeologjike. Numri i vizitorëve në Muze, Kala e Monimente të tjera, si dhe në Parqe Arkeologjike, për vitin 2020 është 190.467 vizitorë. Parqet Arkeologjike janë objektet me të preferuara nga vizitorët ku frekuentohen nga 41,2 % e vizitorëve gjithsej. Në institucionet e trashëgimisë kulturore, 16,8 % e vizitorëve janë të huaj. Në ndryshim nga vitet e kaluara, ku mbi 50 % e vizitorëve ishin të huaj, gjatë vitit pandemik, frekuentimi më i lartë në këto institucione ishte nga vendasit.

Parqet Arkeologjike janë objektet me të preferuara nga vizitorët vendas (44,4 %), ndërsa Kalatë e Monimente të tjera frekuentohen më shumë nga vizitorët të huaj (43,1 %).

Përkufizim:

Trashëgimi kulturore është tërësia e pasurive kulturore, materiale dhe jomateriale, të një individi, grupi ose shoqërie të trashëguar nga e kaluara që ruhet në të tashmen, për t'ua përçarur brezave në të ardhmen si pjesë e pasurisë kombëtare të një vendi, të cilat shprehin vlerat, identitetin, njohuritë, traditat, besimet, si dhe pasuritë kulturore të peizazhit.



A EDINISE?

Kala dhe Monimente të tjera janë objektet më të preferuara nga vizitorët e huaj ku frekuentohen me 43,1 %.




SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

PUNËSIMI



FIG.1 SHKALLA E PUNËSIMIT, GRUPMOSHA 20-64 VJEÇ; 2020



Burimi: EUROSTAT dhe INSTAT

TAB. 1 STATUSI NË LIDHJE ME PUNËSIMIN I POPULLSISË

	Njësia	2018	2019	2020
Popullsia gjithsej	1 000	2.870	2.862	2.846
Forcat e punës gjithsej	-	1.404	1.430	1.408
Meshkuj	-	791	795	779
Femra	-	613	635	629
Të punësuar gjithsej	-	1.230	1.266	1.243
Meshkuj	-	690	703	690
Femra	-	540	563	554
Shkalla e punësimit*	përqindje	59,5	61.2	60.6
Meshkuj	-	66,7	68.2	67.8
Femra	-	52,4	54.4	53.6

Burimi: Anketat e Forcave të Punës, 2018-2020

*) Illogaritur mbi popullsinë 15-64 vjeç

Përkufizim:

FORCAT E PUNËS

Shuma e personave të punësuar dhe të papunë në moshë 15 vjeç e lart.

A EDINISE?

Në vitin 2020, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës, për femrat 15-64 vjeç me arsim të lartë, ka pësuar rritje në krahasim me vitin paraardhës, nga 79,9 % në 81,1 %.

Në vitin 2020, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 60,6 %. Në Shqipëri meshkujt janë më aktivë në tregun e punës. Shkalla e punësimit për meshkujt 15-64 vjeç në vitin 2020 ishte 67,8 %, ndërsa për femrat 53,6 %, me një hendek gjinor në punësim prej 14,2 pikë përqindje.

Në nivel vendi, sektori i shërbimeve dhe ai bujqësor kanë përqindjen më të lartë të të punësuarve me përkatësisht 43,4 % dhe 36,1 %, ndërsa punësimi në industri përbën 20,5 % të të punësuarve gjithsej në vitin 2020.

Një pjesë e konsiderueshme e femrave në moshë pune punojnë si punëtores pa pagesë në biznesin e familjes, kryesisht në fermat bujqësore. Në vitin 2020, femrat kanë 1,4 herë më shumë gjasa sesa meshkujt për të qenë punëtores pa pagesë në biznesin e familjes; 27,0 % e femrave të punësuarja janë punëtores pa pagesë në biznesin familjar, kundrejt 15,5 % të meshkujve të punësuar.

Në vitin 2020 përqindja e punësimit informal në sektorin jo-bujqësor është 29,1 %, duke pësuar një rënie me 0,9 pikë përqindje krahasuar me vitin 2019.




SHOIPËRIA NË SHIFRA 2020

PAPUNËSIA



FIG. 1 TË RINJ TË MOSHËS 15-29 JO NË PUNËSIM DHE AS NË ARSIMIM APO TRAINIM (NEET), (NË DISA VENDE TË RAJONIT(%))



TAB. 1 PAPUNËSIA

	Njësia	2018	2019	2020
Të papunë	1 000	173	165	165
Meshkuj	-	100	92	90
Femra	-	73	72	75
Shkalla e papunësisë	%	12.3	11.5	11.7
Meshkuj	-	12.7	11.6	11.5
Femra	-	11.9	11.4	11.9

Burimi: Anketa e Forcave të Punës 2018 - 2020

Përkufizim:

SHKALLA E PAPUNËSISË

Të papunët si përqindje ndaj totalit të forcave të punës.

PAPUNËSIA

Personat 15-74 vjeç të cilët në një periudhë të caktuar reference plotësojnë njëkohësisht këto tre kriterë: nuk kishin një punë, ishin duke kërkuar punë aktivisht dhe janë të gatshëm që të fillojnë punë nëse do t'u ofrohej një e tillë (në përputhje me përkufizimin e ILO-s).

Tregu shqiptar i punës, gjatë vitit 2020, u karakterizua nga një rritje prej 0,2 pikë përqindje e shkallës së papunësisë, krahasuar me një vit më parë. Shkalla e papunësisë, në këtë vit, arriti në 11,7 % për popullsinë e grup-moshës 15 vjeç e lart, nga 11,9 % që u vlerësua në 2019.

Shkalla e papunësisë ka pësuar ulje për meshkujt dhe rritje për femrat, krahasimisht me vitin 2019. Ky tregues është 11,5 % për meshkujt dhe 11,9 % për femrat në vitin 2020.

Gjatë vitit 2020, shkalla e papunësisë për popullsinë e grup-moshës 15-24 vjeç u ul në 26,5 %, nga 27,2 % që ishte në vitin 2019. Ky tregues u ul nga viti paraardhës me 0,8 pikë përqindje për meshkujt dhe 0,4 pikë përqindje për femrat.

Për popullsinë e grup-moshës 25-54 vjeç, niveli i papunësisë u rrit në 11,4 %, nga 10,6 % që ishte në vitin 2019.

Të rinjtë e grup-moshës 15-29 vjeç të cilët nuk janë as në punësim e as duke vazhduar shkollën apo ndonjë trajnim përbëjnë 27,9 % të të rinjve gjithsej për vitin 2020.

Shkalla e papunësisë së femrave 15-24 vjeç me arsim të mesëm, pësoi një rënie prej 4,7 pikë përqindje, krahasuar me një vit më parë.

A EDINISE?



SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

ÇMIMET E KONSUMIT



FIG. 1 NDRYSHIMI MESATAR VJETOR I IÇK (%)




FIG. 1 NDRYSHIMI MESATAR VJETOR I IÇK SIPAS GRUPEVE %

		2018	2019	2020
000000	Gjithsej	2,0	1,4	1,6
01.	Ushqime dhe pije joalkoolike	2,7	2,9	3,6
02.	Pije alkoolike dhe duhan	1,8	1,3	0,6
03.	Veshje dhe këpucë	1,5	0,0	-0,6
04.	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	2,8	0,7	1,4
05.	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,0	0,9	1,5
06.	Shëndeti	-0,2	-0,3	-0,5
07.	Transporti	2,4	-0,2	-3,2
08.	Komunikimi	0,7	0,1	0,2
09.	Argëtim dhe kulturë	2,7	1,0	1,5
10.	Shërbimi arsimor	0,6	0,6	0,1
11.	Hotele, kafene dhe restorante	0,9	1,1	0,7
12.	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,2	0,1	0,5

Ndryshimi mesatar vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit në vitin 2020 është 1,6 %.

Rritja më e madhe e çmimeve prej 3,6 % vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” duke kontribuar me +1,32 pikë përqindje në ndryshimin vjetor. Indekset e grupeve “Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” dhe “Argëtim e kulturë” kanë shënuar një rritje prej 1,5 % secili duke kontribuar respektivisht me +0,09 dhe +0,04 pikë përqindje. Indeksi i grupit “Qira, ujë lëndë djegëse dhe energji” ka shënuar një rritje prej 1,4 % me një ndikim prej +0,30 pikë përqindje. Indeksi i grupit “Pije alkoolike dhe duhan” ka shënuar një rritje prej 0,6 % duke ndikuar me +0,02 pikë përqindje.

Ulje më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Transporti” me 3,2 % duke kontribuar me -0,21 pikë përqindje. Në grupet e tjera ndryshimi vjetor varion nga -0,6 % në +0,7 %.

A EDINISE?

Në vitin 2020 Indeksi i Çmimeve të Konsumit të nëngrupit “fruta” shënoi një rritje 15,2 % nga 5,2 % që ishte një vit më parë




SHOIPËRIA NË SHIFRA 2020

PRODUKTI I BRENDSEHM BRUTO



FIG. 1 PRODUKTI I BRENDSEHM BRUTO



Metodë prodhimi

Gjatë vitit 2020, ekonomia Shqiptare shënoi një rënie në terma reale prej 3,96%, krahasuar me vitin 2019, bazuar kjo mbi vlerësimin paraprak të PBB-së mbështetur në vlerësimet tremujore.

Përsa i përket strukturës së PBB sipas aktiviteteve ekonomike, peshën më të madhe në ekonomi për vitin 2020 vazhdojnë ta zënë Shërbimet gjithsej me 48,36 % të PBB, të cilat u ulën me 4,61% në terma realë. Industria dhe Ndërtimi përbëjnë 20,06 % të PBB-së të cilat shfaqën një ecuri në terma realë përkatësisht: Industria pësoi një rënie prej 7,03% ndërsa Ndërtimi një rritje prej 1,88%. Bujqësia, gjuetia, pyjet dhe peshkimi përbëjnë 19,12% të PBB-së dhe janë rritur me 0,33 % në terma realë.

TAB. 1 LLOGARITË KOMBËTARE

Struktura e PBB sipas aktiviteteve kryesore (%)

	Njësia	2017	2018*	2019**	2017	2018*	2019**
PBB (me çmime korrente)	Miln lekë	1.550.645	1.636.731	1.691.729	100,00	100,00	100,00
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi (Nace Rev.2, A)	-	294.966	301.641	311.130	19,02	18,43	18,39
Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike & gazi (Nace Rev.2, B-E)	-	173.995	201.251	204.046	11,22	12,30	12,06
Ndërtimi (Nace Rev.2, F)	-	141.692	147.036	144.591	9,14	8,98	8,55
Shërbimet (Nace Rev.2, G -U)	-	743.838	781.630	819.058	47,97	47,76	48,42

2019* Të dhëna gjysëm finale

2020** Të dhëna nga PBB tremujore

A EDINI SE?

Në vitin 2020, ekonomia shqiptare shënoi një rënie në terma realë (në volum) prej 3,96%, krahasuar me vitin 2019, pas një rritje prej 2,11% në vitin 2019, krahasuar me vitin 2018.



SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

PRODUKTI I BRENDSEM BRUTO



TAB . 1 LLOGARITË KOMBËTARE

		Struktura e PBB (%)					
	Njësia	2018	2019*	2020**	2018	2019*	2020**
Burimet (me çmime korrente)	Mln lekë	2.377.126	2.452.661	2.229.923			
PBB me çmime tregu	Mln lekë	1.636.731	1.691.729	1.617.541	100,0	100,0	100,0
Importet e mallrave e shërbimeve e (fob)	-	740.395	760.932	612.382	45,2	45,0	37,9
Përdorimet (me çmime korrente)	-	2.377.126	2.452.661	1.702.537			
Eksportet e mallrave e shërbimeve e (fob)	-	516.748	529.638	373.831	31,6	31,3	23,1
Konsumi Final i Popullatës	-	1.281.812	1.338.334	1.328.706	78,3	79,1	82,1
Konsumi Final i Administratës Publike dhe i Institucioneve Jo -timprurëse	-	197.698	205.276	207.069	12,1	12,1	12,8
Formimi Bruto i Kapitalit Fiks	-	390.567	377.068	371.754	23,9	22,3	23,0
Ndryshimet e gjendjeve dhe mospërputhje statistikore	-	(9.698)	2.345	(51.437)	(0,6)	0,1	-3,2
Rritja vjetore e PBB (krahasuar me çmimet e vitit të mëparshëm)	%	4,02	2,11	(3,96)			
	1.000 lekë	571	593	570			
Produkti i Brendshëm Bruto për frymë	Euro	4.476	4.819	4.605			
	USD	5.287	5.396	5.252			

2019* Të dhëna gjysëm finale
2020** Të dhëna nga PBB tremujore

Metodë shpenzimi

Sipas PBB-së me metodën e shpenzimeve, Konsumi final përbën peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi, me 94,95% . Ky komponent pësoi ulje me 0,51% në terma nominalë dhe 1,88% në terma realë . Në strukturën e Konsumit Final është konsumi final i popullatës ai që zë peshën më të madhe me 82,14 %, i ndjekur nga konsumi i administratës publike me 12,07 % dhe konsumi i institucioneve jo-fitimprurëse në shërbim të familjeve (IJFSHF) me 0,70 %. Në vitin 2020, Formimi bruto i kapitalit fiks, i cili përbën 22,98% të PBB-së, pësoi ulje me 1,41 % në terma nominalë dhe 2,03% në terma realë, krahasuar me vitin 2019. Eksportet e mallrave dhe shërbimeve u ulën me 29,42 %, në terma nominalë dhe me 25,58 % në terma realë, ndërkohë që Importet e mallrave dhe shërbimeve u ulën me 19,52 %, në terma nominalë dhe 19,90 % në terma realë, krahasuar me vitin 2019.

A EDINISE?

Në vitin 2020, Formimi bruto i kapitalit fiks, i cili përbën 22,98% të PBB-së, u shfaq me një rënie prej 2,03% në terma realë, krahasuar me vitin 2019.




SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

TREGTI E JASHTME



FIG. 1 TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE (NË % NDAJ PBB)



TAB. 1 TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE

milion lek

	2000	2005	2010	2015	2020
Eksporte (FOB)	37.037	65.818	161.548	243.183	271.955
Importe (CIF)	157.109	262.191	477.768	544.616	605.262
Bilanci tregtar (Exports-Imports)	-120.072	-196.373	-316.220	-301.433	-333.307
Volumi tregtar (Exports+Imports)	194.146	328.009	639.315	787.799	877.217
Përqindja e mbulimit (%)	23,6	25,1	33,8	44,7	44,9

TAB 2. PESË PARTNERËT KRYESORË TREGTARË, 2020

Exporte			Importe		
	milion lekë	% ndaj gjithsej		milion lekë	% ndaj gjithsej
Itali	123,510	45.4	Itali	151,978	25.1
Kosovë	26,247	9.7	Turqi	57,943	9.6
Spanjë	16,601	6.1	Greqi	54,454	9.0
Gjermani	16,008	5.9	Kinë	54,038	8.9
Greqi	13,211	4.9	Gjermani	46,601	7.7

Në vitin 2020 volumi tregtar i mallrave është ulur me 7,5 % krahasuar me 2019, duke patur një ulje vjetore për eksportet rreth 9,0 % dhe 6,8 % për importet.

Grupet më të rëndësishme të mallrave që eksporton Shqipëria janë: “Tekstile dhe artikuj tekstile”, “Veshjet e këmbëve” dhe “Produktet minerale”. Në vitin 2020 këto grupe kanë zënë respektivisht 20,8 %, 16,8 % dhe 14,7 % të eksporteve gjithsej.

Grupet më të rëndësishme të mallrave që importon Shqipëria janë: “Makinë e pajisje mekanike dhe elektrike” dhe “Tekstile dhe artikuj tekstile”. Në vitin 2020 këto grupe kanë zënë respektivisht 15,0 % dhe 10,5 % të importeve gjithsej.

Tre nga partnerët kryesorë si për eksportet, ashtu edhe për importet për vitin 2020, janë Italia, Greqia dhe Gjermania, duke zënë rreth 56,2 % të eksporteve shqiptare dhe 41,8 % të importeve shqiptare.

A EDINI SE?

Në vitin 2020 Greqia është partneri i dytë kryesor përsa i përket volumit tregtar duke zënë rreth 7,7 % të gjithë tregtisë së mallrave




SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT NË NDËRMARRJE

TAB. 1 PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT NË NDËRMARRJE, 2018-2020

	2018	2019	2020
Ndërmarrje që përdorin kompjuter	97,3	97,5	98,3
Punonjës që përdorin kompjuter në ndërmarrje	26,0	26,8	27,2
Ndërmarrje që kanë akses në internet	97,5	97,8	98,2
Ndërmarrje që kanë faqe internet	44,9	44,5	44,6
Ndërmarrje që përdorin media sociale për qëllime pune	52,4	59,5	66,6
Ndërmarrje që shesin produkte/shërbime online	5,6	5,8	12,8

FIG. 1 NDËRMARRJE QË SHESIN PRODUKTE/SHËRBIME ONLINE, 2020



TAB. 2 PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT NË NDËRMARRJE SIPAS MADHËSISË SË NDËRMARRJES, 2020

Madhësia e ndërmarrjes	Ndërmarrje që përdorin kompjuter	Ndërmarrje që kanë akses në internet	Ndërmarrje që shesin produkte/shërbime online
Gjithsej	98,3	98,2	12,8
10-49 të punësuar	97,9	97,8	11,9
50-249 të punësuar	100,0	99,5	14,5
250+ të punësuar	100,0	100,0	19,7

Ndërmarrjet që e kanë përdorur kompjuterin për qëllime pune gjatë vitit 2020, përfaqësojnë 98,3 % të ndërmarrjeve ekonomike, nga 97,5% që ishte në 2019.

Punonjësit që kanë përdorur kompjuter për qëllime pune përbëjnë 27,2 % të të punësuarve gjithsej të ndërmarrjeve, nga 26,8 % që ishte në 2019.

Përqindja e ndërmarrjeve që kanë akses në internet është 98,2 % e ndërmarrjeve gjithsej që përdorin kompjuter, duke u rritur me 0,4 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2019.

Në vitin 2020, ndërmarrjet që kanë përdorur faqe interneti janë 44,6 % e ndërmarrjeve që përdorin kompjuter me akses në internet.

Peshën më të madhe të tregtisë elektronike e zënë ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet në fushën e informacionit dhe komunikacionit me 38,2 %.

Përkufizim:



Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK):

I referohet teknologjive që sigurojnë akses në informacione përmes telekomunikimit që përfshijnë internetin, rrjetin, celularët dhe media të tjera komunikimi.



A EDINISE?

Në vitin 2020, përqindja e ndërmarrjeve me 50+ të punësuar përdorimin kompjuter me akses në internet është 100 %?




SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

STATISTIKAT E PËRDORIMIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT NË FAMILJE DHE INDIVIDË



FIG. 1 PËRDORIMI I E-QEVERISJES 2019-2020, NË %



Përkufizim:



Interneti: është sistemi rrjeteve kompjuterike të ndërlidhura që përdorë Suitën e Protokollit të Internetit (TCP/IP) për të lidhur miliarda pajisje në të gjithë botën. Ai është një rrjet i rrjeteve që përbëhet nga miliona rrjete private, publike, akademike, biznese, dhe qeveritare, me fushëveprim lokal deri në global, të lidhura nga një koleksion i gjerë elektronik, wireless, dhe teknologjitë e rrjeteve optike.



A EDINISE?

Rritja më e lartë në vitin 2020 është shënuar në blerjet “online” për “ushqime / pije nga dyqanet apo ofruesit” me 16,6 pikë përqindje ndjekur nga blerjet për “ilace / suplemente apo vitamina” me rreth 9,2 pikë përqindje krahasuar me vitin 2019.

Përdorimi i TIK nga individët e grupmoshës 16 - 74 vjeç

Në vitin 2020, 72,2 % e popullsisë nga 16 - 74 vjeç e përdorin internetin në “tre muajt e fundit” nga momenti i kryerjes së intervistës, prej të cilëve 88,2 % e përdorin atë në baza ditore dhe 10,8 % (të paktën një herë në javë). Përqindja e individëve të moshës 16 - 74 vjeç që kryejnë thirrje/video thirrje (përmes Skype, Viber, WhatsApp) gjatë tre muajve të fundit nga momenti i kryerjes së intervistës, në vitin 2020 është 96,2 %. Shpërndarja e individëve që kryejnë thirrje / video thirrje (përmes Skype, Viber, WhatsApp) “gjatë tre muajve të fundit” tregon se grup-mosha 25-34 vjeç ka shënuar përqindjen më të lartë 26,5% ndjekur nga grup-mosha 16-24 vjeç 21,0%.

Familjet me akses në internet

Përqindja e familjeve shqiptare që kanë akses në internet në vitin 2020 është 83,3 %, krahasuar me 82,2 % të një viti më parë.

Përdorimi i e-qevesisjes

Në vitin 2020 të gjitha kategoritë për kontaktet elektronike nëpërmjet internetit me autoritetet publike dhe disa shërbime publike, kanë shënuar rritje. 93,9 % e individëve që kanë ndërvepruar me autoritet publike nëpërmjet internetit kanë mbetur të kënaqur me shërbimet publike të ofruara.

Përdorimi i e-blerje (blerje online)

Blerjet “online” janë kryer nga 19,5 % e popullsisë së grupmoshës 16 - 74 vjeç në 12 muajt e fundit, nga momenti i kryerjes së intervistës.



SHOIPËRIA NË SHIFRA 2020




TAB. 1 PRODHIMI I BIMËVE TË ARAVE

Bimët e arave	2018	2019	2020
000/ton			
Drithëra buke	678,2	666,1	684,0
-Grurë	240,3	232,2	233,4
-Misër	391,1	389,0	399,1
-Thekër	2,3	2,6	3,2
-Elb	9,7	7,9	12,6
-Tagjiira	34,9	33,4	35,6
Perime & bostanore	1.166	1.258	1.296
Patate	254,5	260,7	254,9
Fasule	24,5	24,8	25,8
Bimë industriale	3,3	3,0	3,1
-Duhan	1,7	1,4	1,4
- Luledielli	0,8	1,0	1,3
-Sojë	0,7	0,6	0,4
Bimë aromatike, mjekësore dhe erëza gatimi	12,5	12,9	14,4
Luleshtrydhe	4,4	5,3	5,4
Foragjere të njoma	7.050	7.115	7.171

Burimi i informacionit: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

FIG. 1 STRUKTURA E PRODHIMIT TË PERIMEVE, 2020



TAB.2 PRODHIMI I PERIMEVE NË SERRA

Perime dhe Bostanore	2018	2019	2020
000/ton			
Gjithsej perime në serra	254	269	283
Domate	140	148	155
Spec	22	25	40
Kastravec	71	74	63
Të tjera perime në serra	21	21	24

Burimi i informacionit: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Bimët e arave

Gjatë vitit 2020 vihet re një tendencë në rritje e prodhimit bujqësor. Prodhimi i perimeve në 2020, në krahasim me 2019 është rritur me 3,0 %.

Në vitin 2020, është shënuar rritje në prodhimet e grupit të bimëve të arave, në kategorinë drithëra buke me 2,7 %, bimët industriale 3,9 % (luledielli 24,3 %) dhe prodhimi i bimëve aromatike, mjekësore dhe erëzave të gatimit me 11,5 %. Në vitin 2020, prodhimi i fasules ka shënuar rritje me 4,1 % ndërsa prodhimi i patates ka pësuar rënie me 2,2 % krahasuar me një vit më parë.

Të ndara sipas kategorive, prodhimi i perimeve përfaqësohet nga perimet e njoma 67,5 % (874.947 ton), bostanoret me 23,0 % (298.887 ton) dhe perimet e thata 9,4 % (121.892 ton).

Prodhimi në serra zë 21,8 % të prodhimit të perimeve gjithsej. Në vitin 2020, prodhimi në serra është rritur me 5,2 % krahasuar me vitin 2019.




SHOIPËRIA NË SHIFRA 2020



FIG.2 SIPËRFAQJA E DRUFRTORËVE, 2018- 2020

000/ha



TAB.3 PRODHIMI I DRUFRTORËVE

000/ton

Drufrutorët	2018	2019	2020
Pëmë frutore	274	274	274
Ullinj	118	98	132
Agrume	45	47	49
Rrush Gjithsej	185	190	199
- Rrush nga vreshtat	110	114	119
- Rrush nga pjergullat	74	76	80

Burimi i informacionit: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Përkufizim:

Statistikat e bujqësisë mbulojnë sipërfaqen, prodhimin dhe rendimentin e drithërave, bimëve industriale, perimet, pemët frutore, agrumet, ullirin dhe vreshtat.

Serrë

Serrë është ambjenti i mbuluar me xham apo me mbulesë të lartë, (që lejon kalimin e personave apo mjeteve mekanike), të fiksuara apo të lëvizshme (xham ose plastikë e fortë ose fleksibël), ku bimët kultivohen gjatë gjithë periudhës apo për pjesën më të madhe të rritjes saj.

Drufrutorët

Sipërfaqja gjithsej e drufrutorëve në vitin 2020 është rritur me 2,5 % në krahasim me vitin 2019. Në vitin 2020, ulliri zë 61,2 % të sipërfaqes së drufrutorëve, pasuar nga pemët frutore që zënë 23,5 % të sipërfaqes gjithsej.

Prodhimi i drufrutorëve ka shënuar rritje nga viti në vit. Në vitin 2020, prodhimi i ullirit ka një rritje të konsiderueshme prej 34,2 %, krahasuar me vitin 2019. Gjithashtu, ka shënuar rritje prodhimi i agrumeve me 4,9 %, dhe prodhimi i rrushit me 4,8 %.



A EDINISE?

1. Në vitin 2020, përqindjen më të lartë të prodhimit gjithsej të perimeve e zë qarku i Fierit me 39%.
2. Në vitin 2020, mandarina zë 65,4% të prodhimit gjithsej të agrumeve.



SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

BLEGTORIA



TAB. 1 NUMRI I BAGËTIVE, (000 KRERË)

Tregues	2018	2019	2020
Gjedhë	467.3	415.6	362.6
- Lopë	342.7	316.4	289.5
Të imta	2,781.0	2,621.2	2,332.2
Të leshta	1,863.8	1,758.3	1,557.9
- Dele	1,366.2	1,296.7	1,174.5
Të dhirta	917.2	862.9	774.3
- Dhi	699.2	670.9	618.6
Derra	184.1	183.8	158.4
- Dosa	12.1	13.5	13.4
Njethundrakë	88.4	86.5	78.6
Shpendë	8,362.5	8,179.2	7,906.7
Bletë (koshere)	285.5	288.3	358.4

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

TAB. 2 PRODHIMET BLEGTORALE, (000 TON)

Treguesit	2018	2019	2020
Qumësht	1,144.4	1,112.2	1,052.2
Qumësht lope	973.5	946.6	897.3
Qumësht dele	84.8	81.7	74.6
Qumësht dhie	86.0	84.0	80.2
Mish peshë e gjallë	161.4	156.6	150.4
Mish gjedhi	68.8	66.1	62.3
Mish të imtash	55.9	54.1	51.6
Mish derri	16.9	16.4	15.3
Mish shpendi	19.7	20.0	21.0
Lesh (ton)	3,331.2	3,182.1	2,831.5
Vezë (në mil)	827.5	864.5	861.0
Mjaltë (ton)	3,936.7	4,116.0	4,599.2

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Gjatë vitit 2020 vihet re një tendencë në rënie e numrit të krerëve të blegtorisë. Krahasuar me një vit më parë rënie ka pësuar numri i gjedhëve me rreth 12,8 %, numri i të leshtave me 11,4 % dhe numri i të dhirtave me 10,3 %. Ndërkohë rritje ka shënuar numri i bletëve me rreth 24,3 % krahasuar me vitin 2019.

Në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 rritje ka shënuar prodhimi i mjaltit me 11,7 %, ndërsa rënie ka pësuar prodhimi i vezëve me 0,4 % dhe prodhimi i mishit peshë e gjallë me rreth 4,0 %.

Prodhimi i qumështit, ka pësuar një rënie me 5,4 % krahasuar me vitin 2019 dhe ndërkohë struktura e prodhimit të qumështit është: qumësht lope 85,3 %, qumësht dhie 7,6 % dhe qumësht dele 7,1 %,



Përkufizim:

Blegtoria mbulon të gjitha kafshët pavarësisht nga mosha, vendndodhja ose qëllimi i mbarështimit të tyre për përmirësim racor apo për prodhime blegtorale.

A EDINISE?

Një vëmendje të veçantë po merr mbarështimi bletëve ku vërehet një zgjerim i aktivitetit të fermerëve në disa zona të vendit. Ky sektor gjatë vitit 2020, ka shënuar rritje me 24 % të numrit të koshereve krahasuar me një vit më parë.



SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

PESHKIMI




TAB. 1 PESHKIMI (TON)

Kategoritë	2018	2019	2020
Peshkimi gjithsej	14.875	15.011	16.892
Detar	5.537	5.499	4.521
Bregdeti	315	342	365
Laguna	350	94	79
Ujërat e brendshme	2.427	2.772	2.844
Akuakultura	5.138	5.229	8.799
Molusqe	1.108	1.075	285

Burimi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

FIG. 1 PESHKIMI GJITHSEJ (TON)



A EDINISE?

Gjatë vitit 2020 rritjen më të madhe e ka shënuar sektori i Akuakulturës me rreth 68,3 % krahasuar me vitin 2019.

Peshkimi përfshin të gjitha të dhënat e aktivitetit të flotës dhe kapacitetin prodhues të sipërfaqeve të ndryshme të peshkimit.

Aktiviteti i peshkimit i referohet të gjitha veprimtarive të lidhura me kërkimin e peshkut, vendosjen dhe tërheqjen e mjeteve të peshkimit, transferimin në bord të zënieve, ruajtjen dhe transformimin në bord, vendosjen në kosha, rritjen dhe shkarkimin e peshqve dhe produkteve të peshkimit.

Të dhënat i referohen sasisë së zënies të të gjitha llojeve të specieve detare (të peshkut, krustance, molusqe etj), specieve të ujrave të ëmbla (lumenj, liqene, ujëmbledhësa, akuakulturë). Në vitin 2020, zënia e peshkut nga të gjitha kategoritë ujore, ka qenë 16.892 tonë nga 15.011 tonë që ishte në vitin 2019, duke pësuar një rritje në terma vjetorë me rreth 12,5 %. Akuakultura ka shënuar rritje me ritme të shpejta si një sektor me perspektivë. Gjatë vitit 2020 u kultivuan në rezervate dhe vaska të ndryshme të specializuara rreth 8.799 ton peshk ose rreth 68,3 % më shumë se viti 2019. Struktura e zënieve sipas kategorisë ujore, për vitin 2020 përcakton “Akuakulturën” si kategorinë me prodhimin më të lartë për sektorin, me 52,1 %, ndaj prodhimit gjithsej, pasuar nga peshkimi “Detar” me 26,8 % si dhe Ujërat e brendshme me 16,8 %, ndaj totalit.





TAB 1. MBETJET URBANE DHE INERTE TË MENAXHUARA SIPAS QARQEVE, 2019

Qarqet	Mbetje Urbane		Mbetje Inerte
	Sasia Mbetje Urbane (ton)	Kg/banorë	Sasia Mbetje Inerte (ton)
2017	1,253,913	437	162,330
2018	1,325,071	462	73,522
2019	1,086,692	381	217,781

Burimi i informacionit: INSTAT - Vrojtimi vjetor 2020 mbi mbetjet urbane në vitin 2019

Mbetjet urbane dhe inerte Mbetjet 2019

Mbetjet e ngurta urbane, janë mbetjet e ngurta familjare dhe mbetjet e tjera të ngjashme me to, të cilat menaxhohen me fonde publike si shërbime komunitare ndaj popullatës në zonat e banuara qoftë dhe përkohësisht. Statistikat e mbetjeve urbane u referohen të dhënave vjetore të përgjithësuara në nivel vendi për prodhimin e treguesve statistikor standard, sipas përcaktimeve në legjislacionin Shqiptar dhe atij Evropian. Treguesit mbi sasinë e mbetjeve për banorë, i referohen popullsisë rezidente dhe sasisë totale të mbetjeve të menaxhuara me fonde publike, nën kujdesin e bashkive në të gjithë vendin. Në vitin 2019 rezultoi të jenë menaxhuar 1,08 milion ton mbetje urbane nga 1,32 milion ton në vitin 2018, duke shënuar një ulje me rreth 17,9 pikë përqindje.

Sasia vjetore e mbetjeve të menaxhuara për banorë në shkallë vendi, ka patur luhatje të vazhdueshme. Kjo shifër është 381 kg/banorë në vitin 2019 nga 462 kg/banorë që ishte në vitin 2018, duke shënuar rënie me rreth 17,5 %.



AEDINISE?

Sasia e mbetjeve të ricikluara në vitin 2019, është 18,7 pikë përqindje nga 18,5 pikë përqindje që ishte në vitin 2018, gjithashtu dhe shkalla e mbulimit të popullatës me shërbime komunitare për menaxhimin e mbetjeve urbane nga bashkitë, ka rruajtur trendin rritës."



SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

CILËSIA E UJËRAVE LARËS NË PLAZHET E SHQIPËRISË



TAB. 1 CILËSIA E UJËRAVE LARËS NË PLAZHET E SHQIPËRISË


Stacione* Plazhet	2017	2018	2019
Velipojë	7	7	7
Shëngjin	8	8	8
Durrës	21	21	21
Kavajë	15	15	15
Vlorë	16	16	16
Dhërmi	5	5	5
Himarë	7	7	7
Borsh	3	3	3
Sarandë	6	6	6
Gjiri i Lalzit	3	3	5
Qeparo	2	2	2
Ksamil	3	3	3

* Shënim : Numri i stacioneve të monitoruara në plazhe

* Cilësia shpreh shkallën në përqindje e plotësimit të standardeve cilësore sipas OBSH në plazhet përkatëse
Burimi i informacionit: Ministria e Mjedisit

Plazhet - 2019

Në vitin 2019 plazhet me cilësinë më të mirë të ujërave rezultojnë plazhi i Dhërmiut, Himarës dhe Borshi, ku respektivisht 100 % e stacioneve të vrojtuar janë vlerësuar me cilësi të shkëlqyer. Treguesit e cilësisë së ujërave larës në plazhet e Shqipërisë, kanë qëndruar përgjithësisht në të njëjtat nivele, me cilësi të shkëlqyer ose të mirë, në 85 % të tyre. Të dhënat për cilësinë e ujërave në plazhet e Shqipërisë, u referohen matjeve të përsëritura në të gjitha plazhet detare. Këto të dhëna i referohen kryesisht përmbajtjes së kolonive të baktereve me origjinë nga shkarkimet në ujërat detare dhe ujërat e brendshme.





SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

TAB. 1 FONDI PYJOR SIPAS PRONËSISË

	Sip.Ha			Volumi 000m ³		
	2017	2018	2019	2017	2018	2019
Pyje gjithsej	1,051,871	1,051,859	1,051,843	54,925	54,878	54,847
Pyje publikë	1,023,091	1,023,079	1,023,063	51,631	51,584	51,553
Pyje privatë	28,780	28,780	28,780	3,294	3,294	3,294

Burimi i informacionit: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Pyll është sipërfaqja e tokës me një grup të dendur drurësh pyjorë, në formë të qëndrueshme ose me bimësi tjetër të rrallë pyjore, me sipërfaqe më të madhe se një dynym e me shkallë mbulimi jo më të vogël se 30 %, që prodhon masë drusore, ushtron ndikim në mjedisin rrethues dhe që siguron funksionet e pyllit.

Pyjet e Shqipërisë, në vitin 2019, shtrihen në një sipërfaqe prej 1.051.843 ha, që përfaqëson 60,44 % të fondit pyjor dhe kullosor, me një vëllim të përgjithshëm të lëndës drusore 54.847/000 m³.



A EDINISE?

Në vitin 2019 përqindjen më të madhe në fondin pyjor e zenë pyjet fletore me 49,8 % të sipërfaqes totale duke pasuar nga shkuret me 35,8 % dhe 14,4 % nga pyjet halorë.

SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020



BIODIVERSITETI



TAB. 1 RRJETI I ZONAVE TË MBROJTURA

	Numri i zonave të mbrojtura (nr)			Sipërfaqja e zonave të mbrojtura (ha)		
	2017	2018	2019	2017	2018	2019
Gjithsej	800	801	776	477,566	523,831	523,831
Rezervë natyrore,shkencore	2	2	2	4,800	4,800	4,800
Parqe Kombëtare	15	14	14	210,501	230,707	230,707
Monument natyre	750	750	725	3,470	3,470	3,470
Rezervë Natyrore e Menaxhuar	24	25	25	144,685	169,275	169,275
Peisazh i mbrojtur (tokë,det,ujë)	5	6	6	95,864	97,333	97,334
Rezervë e Burimeve të Mbrojtura	4	4	4	18,245	18,245	18,245

Burimi i informacionit: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Zonat e mbrojtura

“Zona të mbrojtura” shpallen territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat menaxhohen me rrugë ligjore dhe me metoda shkencore bashkëkohore. Zonat e mbrojtura ndahen në 6 kategori të cilat janë: Park kombëtar, Monument natyror, Rezervat natyror i menaxhuar, Peisazhi i mbrojtur, Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara.

Përkufizim:

Në vitin 2019 ka pasur ndryshime në numrin e zonave të mbrojtura pasi për miratimin e listës të përditësuar të monumenteve të natyrës Shqiptare, është bërë rishqyrtimi i monumenteve natyrorë dhe si rezultat nr i zonave te mbrojtura nga 881 zona te mbrojtura ne vitin 2018 është ulur me 25 zona në vitin 2019 në kategorinë e monumenteve të natyrës,por pa ndikuar në ndryshimin e sipërfaqes.





SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

TRANSPORTI




TAB.1 LËVIZJA E MALLRAVE SIPAS MËNYRËS SË TRANSPORTIT 2020

	Eksporti		Importi	
	milionë lekë	% ndaj gjithsej	milionë lekë	% ndaj gjithsej
Gjithsej	271.955	100	605.262	100
Transport detar	151.153	55,6	279.592	46,2
Transport hekurudhor	5	0,0	2.999	0,5
Transport rrugor	115.613	42,5	287.441	47,5
Transport ajror	1.257	0,5	18.085	3,0
Të tjera	3.928	1,4	17.146	2,8

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

FIG. 1 TRANSPORTI I PASAGJERËVE SIPAS LLOJEVE TË TRANSPORTIT, 2018-2020



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

TAB.2 TREGUESIT E TRANSPORTIT AJROR, 2018-2020

	2018	2019	2020
Numri i fluturimeve	25.510	28.695	15.280
Numri i mbikalimeve	176.130	188.032	87.157
Numri i shoqërive ajrore	21	21	17

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

**Përkufizim:****Volumi i mallrave:**

Çdo e mirë e transportuar nëpërmjet anijeve tregtare, hekurudhës apo transportit detar.



Në vitin 2020, rreth 49,1 % e volumit tregtar të mallrave është transportuar me det. Numri i pasagjerëve të transportuar nëpërmjet ajrit ndaj pasagjerëve gjithsej të transportuar me Det, Hekurudhë dhe Ajër është rritur me 11,9 pikë përqindje në krahasim me vitin 2018.



SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

TURIZMI NË SHQIPËRI




TAB.1 HYRJET E SHTETASVE TË HUAJ NË PIKAT KUFITARE KOMBËTARE SIPAS KOMBËSISË

	2018	2019	2020
Gjithsej	5,926,803	6,406,038	2,657,818
I . Afrika	3,457	21,645	1,636
II. Amerika	148,845	153,579	30,020
III. Azia Lindore dhe Paqësori	68,121	66,757	4,993
IV. Lindja e Mesme	7,174	11,005	1,813
V. Azia e Jugut	3,115	3,167	801
VI. Evropa	5,331,614	5,774,226	1,237,536
- Evropa Qëndrore / Lindore	362,083	371,988	92,326
- Evropa Veriore	212,246	234,902	65,173
- Evropa Jugore	4,301,996	4,635,974	956,542
- Evropa Perëndimore	357,411	416,983	95,211
- Evropa Lindore / Mesdheut	97,878	114,379	28,284
VII. Rajone të paspecifikuara	364,477	375,659	1,381,019

FIG. 1 DALJET E SHTETASVE SHQIPTARË DHE HYRJET E SHTETASVE TË HUAJ

000 / shtetas



Përkufizim:



Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë). Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë). Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Lëvizja e shtetasve

Hyrjet e shtetasve të huaj në pikat kufitare për vitin 2020, kanë rënë me 58,5 % ndërkohë daljet e shtetasve shqiptarë kanë rënë me 55,5 % krahasuar me vitin 2019.

Në vitin 2020, hyrjet e shtetasve nga rajoni i Evropës zënë peshën më të madhe të hyrjeve të shtetasve të huaj gjithsej me 46,6 %.

Evropa Jugore zë përqindjen më të lartë të hyrjeve të shtetasve të huaj me 77,3 % të hyrjeve gjithsej ndjekur nga Evropa Perëndimore me 7,7 % të hyrjeve, Evropa Qëndrore / Lindore me 7,5 % të hyrjeve të shtetasve të huaj, Evropa Veriore me 5,3 % dhe Evropa Lindore / Mesdheut me 2,3 %.

A EDINISE?

Hyrjet e shtetasve të huaj gjatë vitit 2020 nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi zënë 72,4% të hyrjeve të shtetasve të huaj gjithsej.



SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

TURIZMI NË SHQIPËRI



TAB. 2 STRUKTURAT AKOMODUESE ME NUMËR DHOMA DHE SHTRETËR, 2018 – 2020

Përshkrimi i llojit të strukturës akomoduese				Dhoma			Shtretër		
	2018	2019	2020	2018	2019	2020	2018	2019	2020
Hotele dhe struktura të ngjashme	1.021	1.126	1.237	30.524	33.798	34.713	69.395	77.974	82.434
Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime kolektive	268	208	177	3703	3607	4230	9478	9574	11327
Hapësirat për kampingje, për parqe, për çadra ose rulota argëtimi	37	71	55	293	629	587	685	1399	1481
Gjithsej	1.326	1.405	1.469	34.520	38.034	39.530	79.558	88.947	95.242

TAB. 3 NETË QËNDRIME DHE KOHËZGJATJA MESATARE E QËNDRIMIT, 2018 - 2020 NETË QËNDRIME. MESATARJA E NETËVE

	Netë qëndrime			Mesatarja e netëve		
	2018	2019	2020	2018	2019	2020
Rajonet						
Rajoni i Veriut	915.992	1.078.360	461.800	3,1	3,3	3,6
Rajoni Qendror	1.095.904	1.076.512	488.603	2,3	2,3	2,0
Rajoni i Jugut	1.062.761	1.098.547	655.041	2,2	2,4	2,2
Zonat e afërsisë me bregdetin						
Zona Bregdetare	1.610.265	1.913.448	1.091.836	3,1	3,4	3,0
Zona Jo bregdetare	1.464.392	1.339.971	513.608	2,0	2,0	1,7
Përshkrimi i llojit të strukturës akomoduese						
Hotele dhe struktura të ngjashme	2.698.255	3.002.289	1.478.022	2,4	2,6	2,3
Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime kolektive	350.670	221.669	115.957	2,9	3,1	4,0
Hapësirat për kampingje, për parqe, për çadra ose rulota argëtimi	25.732	29.461	11.465	2,1	2,0	2,0
Gjithsej	3.074.657	3.253.419	1.605.444	2,5	2,6	2,4

Strukturat akomoduese

Gjatë vitit 2020, në vend numërohen 1.469 struktura akomoduese, ndër të cilat 1.217 kanë qenë aktive të paktën një muaj gjatë vitit me një kapacitet maksimal prej 39.530 dhoma dhe 95.242 shtretër. Numri i strukturave akomoduese është rritur me 4,6 % krahasuar me 2019 dhe 10,8 % krahasuar me 2018.

Numri i netë qëndrimeve të vizitorëve në strukturat akomoduese gjatë vitit 2020, është 1.605.444 duke shënuar rënie 50,7 % krahasuar me vitin 2019 dhe 47,8 % krahasuar me vitin 2018.

Gjatë vitit 2020, kohëzgjatja mesatare e qëndrimit të vizitorëve në strukturat akomoduese është 2.4 netë duke rënë me 0.2 pikë përqindje krahasuar me 2019 dhe me 0.1 pikë përqindje krahasuar me 2018.

Përkufizime

Netë qëndrimi: Është çdo natë që një vizitor rezident ose jo-rezident kalon në një njësi akomodimi.

Struktura akomoduese: Përfshijnë të gjitha njësitë e akomodimit turistik që ofrojnë një shërbim të paguar akomodimi ose qëndrimi afatshkurtër.

Shtrat: Përcaktohet nga numri i personave që mund të qëndrojnë gjatë natës në një shtrat, duke përfshirë shtretërit shtesë të vendosur sipas kërkesës së vizitorit.



A EDINISE?

Gjatë vitit 2020, hotelet dhe strukturat e ngjashme kanë një ofertë mesatare mujore 532.402 dhoma dhe 1.216.721 shtretër të disponueshme për vizitorët. Numri maksimal shënohet në muajin Gusht me 800.920 dhoma dhe 1.920.578 shtretër ndërsa muaji me kapacitetin më të ulët është Prilli me 42.406 dhoma dhe 90.555 shtretër.



SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

TURIZMI NË SHQIPËRI



FIG. 1 PËRQINDJA E UDHËTIMEVE SIPAS MUAJIT TË NISJES, 2019



Përkufizime



Turizmi është veprimtaria e vizitorëve duke ndërmarrë një udhëtim për një destinacion kryesor jashtë vend-banimit të zakonshëm ku jeton, për më pak se një vit, për çfarëdo qëllimi kryesor, duke përfshirë biznesin, kohën e lirë apo qëllime tjera personale. Personi vizitor nuk duhet të jetë i punësuar nga një subjekti rezident në vendin e vizituar. Udhëtar do të konsiderohet individi i cili lëviz në vendeve të ndryshme gjeografike për çdo qëllim dhe kohëzgjatje. Udhëtimi i referohet veprimtarisë së udhëtarëve.

A EDINISE?

Në vitin 2019, 23,4 % e udhëtimeve të kryera në Shqipëri, si vend origjinë kanë qarkun e Tiranës, 12,2% qarkun e Korçës, 11,4% qarkun e Durrësit dhe 10,6 % qarkun e Elbasanit.

Statistikat e turizmit të familjeve

Në vitin 2019, numri i udhëtimeve për qëllime personale apo biznesi (brenda apo jashtë Shqipërisë) të kryera nga individët banues në Shqipëri të moshës mbi 15 vjeç ishte 5.350.604. Udhëtimet për qëllime personale përbëjnë 95,1 % të udhëtimeve gjithsej, ndërsa udhëtimet për qëllime biznesi 4,9 % të tyre. Mesatarisht në vitin 2019 një individ në Shqipëri ka kryer 2,3 udhëtime. Përqëndrimet më të larta të udhëtimeve të kryera janë regjistruar në muajt: Gusht (12,9 %), Mars (10,7 %), Qershor (9,9 %), Dhjetor (9,6 %) dhe Korrik (9,4 %).

Udhëtimet sipas qëllimit

Shpërndarja e udhëtimeve sipas llojit, në vitin 2019 ndjek të njëjtin trend me numrin e udhëtimeve. Udhëtimet e kryera në Shqipëri për qëllime personale zënë peshën kryesore me 77,3 % të ndjekura nga udhëtimet për qëllime personale jashtë Shqipërisë 17,8 %, ndërsa udhëtimet e kryera për qëllime biznesi janë kryer më shumë në Shqipëri (3,3 %), krahasuar me ato të kryera jashtë Shqipërie (1,6 %).

Udhëtimet sipas destinacioneve

Në vitin 2019, destinacionet më të preferuara për udhëtime për qëllime personale apo biznesi në Shqipëri janë qarqet: Tiranë (28,5 %), Korçë (12,3 %), Vlorë (11,6 %) dhe Durrës (10,3 %). Në udhëtimet e kryera jashtë Shqipërie përqindjet më larta janë regjistruar në shtetet si : Greqi (6,6 %), Itali (5,5 %) dhe Kosovë (1,3 %).



SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020


INOVACIONI 2018-2020



TAB. 1 PËRQINDJA E NDËRMARRJEVE AKTIVE DHE JO AKTIVE NË INOVACION SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK DHE MADHËSISË SË NDËRMARRJES, 2018-2020

	Ndërmarrje aktive në Inovacion	Ndërmarrje jo aktive në Inovacion
Gjithsej	36.6	63.4
Aktiviteti ekonomik		
Industri	32.1	67.9
Shërbime	41.0	59.0
Madhësia e ndërmarrjes		
10-49 të punësuar	32.1	67.9
50-249 të punësuar	49.0	51.0
250+ të punësuar	68.2	31.8

FIG. 1 PËRQINDJA E NDËRMARRJEVE AKTIVE NË INOVACION SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK DHE LLOJIT TË INOVACIONIT, 2018-2020 (%)



Gjatë periudhës 2018-2020, 36,6 % e ndërmarrjeve të vrojtura kryen një aktivitet Inovacioni. Aktiviteti i Inovacionit rezulton më i lartë në ndërmarrjet që operojnë në sektorin e shërbimeve me 41,0 %, krahasuar me ndërmarrjet në sektorin e Industrisë me 32,1 %. Aktiviteti i inovacionit rezultoi më i pranishëm në grupin e ndërmarrjeve të mëdha, me mbi 250 të punësuar me 68,2 %.

Gjatë periudhës 2018-2020, 63,4 % e ndërmarrjeve të vrojtura nuk kanë kryer aktivitete Inovacioni. 67,9 % e ndërmarrjeve që operojnë në sektorin e Industrisë nuk rezultojnë inovative, ndërsa ndërmarrjet në sektorin e Shërbimeve rezultojnë 59,0 % jo aktive në Inovacion.

Përqindja më e lartë e ndërmarrjeve që zhvilluan inovacione produktesh, inovacione procesesh dhe inovacione produktesh dhe procesesh së bashku rezultuan në sektorin e Shërbimeve.

Gjatë periudhës 2018-2020, 23,6 % e të gjitha ndërmarrjeve të vrojtura zhvilluan inovacione të produkteve (mallra ose shërbime të reja ose të përmirësuara), ndërsa 31,6 % zhvilluan procese biznesi të reja ose të përmirësuara (Fig. 2).



SHQIPËRIA NË SHIFRA 2020

INOVACIONI 2018-2020



FIG. 2 PËRQINDJA E NDËRMARRJEVE ME INOVACIONE TË PRODUKTEVE DHE PROCESVE NË BIZNES SIPAS MADHËSISË SË NDËRMARRJEVE, 2018-2020 (%)





FIG. 3 STRUKTURA E NDËRMARRJEVE ME INOVACIONE TË PRODUKTEVE, SIPAS LLOJIT TË INOVACIONIT TË PRODUKTIT, 2018-2020 (%)



Gjatë periudhës 2018-2020, 23,6 % e të gjitha ndërmarrjeve të vrojtura zhvilluan inovacione të produkteve (mallra ose shërbime të reja ose të përmirësuara), ndërsa 31,6 % zhvilluan procese biznesi të reja ose të përmirësuara (Fig. 2).

Nga ndërmarrjet me inovacione të produkteve, 37,2 % e tyre zhvilluan mallra të reja ose të përmirësuara dhe 31,4 % e ndërmarrjeve zhvilluan shërbime të reja ose të përmirësuara. Ndërsa ndërmarrjet që zhvilluan së bashku mallra dhe shërbime të reja ose të përmirësuara rezultuan 31,4 % (Fig. 3).

Një inovacion: Është një produkt ose proces i ri ose i përmirësuar (ose kombinimi i tyre) që ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga produktet ose proceset e mëparshme të njësisë dhe që është vënë në dispozicion të përdoruesve të mundshëm ose është sjellë në përdorim nga njësia.

A EDINISE?

Ndërmarrjet në sektorin e Shërbimeve janë më Inovative me 41,0 % krahasuar me ndërmarrjet në sektorin e Industrisë me 32,1 %.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti i Statistikave

Shqipëria në shifra 2020 / Instituti i Statistikave. –
Tiranë : INSTAT, 2021

... f. ; ... cm.

ISBN 978-9928-188-90-8

1.Statistika 2.Shqipëri

311.312(496.5) “2020”